

Ekspozita "Ngjyrat e Lirisë" hapet në Prishtinë, arti në shërbim të kujtesës dhe historisë së luftës së UÇK-së



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

LV-ja DHE LDK-ja PAJTOHEN QË BEKIM SEJDIU TË JETË KANDIDAT PËR PRESIDENT

FAQE 4-5

Minus një votë, Avdullah Hoti kundër



Prof. dr. Bekim Sejdiu është emri për të cilin janë dakorduar kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku dhe kryeministri në detyrë, Albin Kurti, në kuadër të diskutimeve për zgjedhjen e presidentit të Kosovës. Abdixhiku ka bërë me dije

para mediave pas takimit me Kurtin se nga 9 korriku janë zhvilluar takime dhe diskutime të vazhdueshme për çështjen e presidentit. Ai ka thënë se sot, po i japin republikës një zgjidhje të mbarë, të përgjegjshme dhe dinjitoze.

Kjo kandidaturë ka shfaqur menjëherë pakënaqësi brenda LDK-së. Deputeti Avdullah Hoti ka se nuk e përkrah këtë kandidaturë për president, jo për arsye personale, por për një parim politik dhe institucional

PDK-ja DHE ALEANCA PARA QEVERISË: INSTITUCIONET DUHET TË ZHBLLOKOHEN

F. 3



BETOHET PËRBËRJA E RE E KOZ-së, ME NJË ANËTAR MË PAK - HAXHIU NUK IA EMËRON PDK-së EDHE NJË ANËTAR

F. 5



OPINION

HAGA DHE FORMIMI I INSTITUCIONEVE TË KOSOVËS

F. 6

Lulëzim ETEMAJ



AKTUALE



PRISHTINA DO TË KRIJOJË NDËRMARRJE TË RE PUBLIKE KOMUNALE PËR PASTRIMIN

F. 7

DËNOHEN DY TË AKUZUAR PËR BARRIKADAT NË VERI, PËR KATËR TË TJERË GJYQI NIS MË 15 SHTATOR

F. 6

EKONOMI



AKB: PESË SHTETE ZOTËROJNË RRETH 62% TË NAFTËS SË PROVUAR BOTËRORE, MËSIMI PËR KOSOVËN

F. 8

SPORT



EDMOND AZEMI RIKTHEHET TE SIGAL PRISHTINA

F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

SHBA-ja KRYEN SULME TË REJA NDAJ RAKETHEDHËSVE IRANIANË, SHIHEN SI ‘SINJAL’ PËR TEHERANIN LIDHUR ME HORMUZIN

UASHINGTON, 31 GUSHT - Forcat amerikane goditën dy raketehdhës iranianë në ishullin Larak, në Ngushticën e Hormuzit, pasi Garda Revolucionare Islamike e Iranit (IRGC) u vërejt duke u përgatitur të lëshonte raketa me mina detare, konfirmoi për Radion Evropa e Lirë një zyrtar amerikan. Sulmet e 30 gushtit shënojnë sulmin e parë të raportuar publikisht dhe direkt të SHBA-së ndaj pozicioneve ushtarake iraniane në më shumë se një muaj, dhe vijnë në një kohë kur Uashingtoni po përpiqet të rikthejë transportin detar përmes një prej pikave më strategjike të kalimit detar në botë. Zyrtari amerikan tha se forcat e IRGC-së po përgatiteshin të lëshonin raketat me mina detare në ngushticë. Javën e kaluar, Komanda Qendrore e SHBA-së tha se forcat amerikane kishin përfunduar pastrimin e minave detare nga rrugët ndërkombëtare të transportit në ngushticë dhe po monitoronin nga afër aktivitetin atje. “Forcat amerikane po e monitorojnë nga afër zonën dhe mbeten të gatshme për të mbrojtur qarkullimin e lirë të tregtisë përmes kësaj rruge ujore thelbësore”, tha zyrtari. Komanda Qendrore e SHBA-së tha se “forcat amerikane ndërmorën një veprim të kufizuar dhe të saktë kundër forcave të IRGC-së që vendosnin mina dhe që përbënin një kërcënim të menjëhershëm në ngushticën e Hormuzit. Në thelb, Irani krijoi kërcënimin dhe ushtria amerikane e eliminoi atë për të mbrojtur anijet civile, transportin tregtar dhe qarkullimin e lirë të tregtisë globale”. IRGC-ja, forca e linjës së ashpër e Iranit, u zotua për hakmarrje. Në një deklaratë të transmetuar nga mediat shtetërore iraniane, ajo pranoi “martirizimin dhe plagosjen e disa prej luftëtarëve dhe bashkëqytetarëve tanë” dhe tha se sulmi “do të rezultojë në ndëshkimin e agresorit”. Më vonë, IRGC-ja tha se kishte lëshuar raketa balistike ndaj dy bazave ku janë të dislokuara forcat amerikane në Jordani, në shenjë hakmarrjeje. Jordania, aleate e ngushtë e SHBA-së, tha se kishte penguar tetë raketa që hynë në hapësirën e saj ajrore herët më 31 gusht.

Paralajmërim për Hormuzin

Ekspertët e intervistuar nga Radio Evropa e Lirë thanë se sulmi amerikan ka më pak rëndësi si veprim i izoluar ushtarak sesa si



demonstrim se Uashingtoni është i gatshëm të përdorë forcën për të penguar Iranin që të rikthejë aftësinë për të kërcënuar transportin detar përmes Hormuzit. Alex Plitsas, bashkëpunëtor i lartë jorezident në Këshillin e Atlantikut dhe ish-zyrtar i Pentagonit, tha se shkëmbimi i fundit i sulmeve nisi “pasi Irani goditi një anije pranë Omanit dhe më pas po përpiquej të lëshonte një numër të vogël minash në ngushticë”. “SHBA-ja goditi raketehdhësit”, tha ai. Plitsas shtoi se besonte se sulmi iranian ndaj anijes ishte “një përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj deklaratave të SHBA-së për rritjen e flukseve të naftës përmes ngushticës së Hormuzit gjatë javëve të fundit”, me synimin për të treguar se Teherani ende mund të godasë objektiva detare dhe të rrisë nivelin e rrezikut për kompanitë e transportit. Dallimi mes një rruge ujore të bllokuar fizikisht dhe një rruge ujore që është bërë tepër e rrezikshme për transportin tregtar është thelbësor, tha ai për Radion Evropa e Lirë. “Vetë ngushtica është fizikisht e hapur”, tha Plitsas. “Rënia e qarkullimit në këtë pikë vjen kryesisht për shkak të rrezikut të një sulmi iranian ndaj një anijeje”, theksoi ai. Kjo do të thotë se pastrimi i minave dhe shkatërrimi i pikave të identifikuar të lëshimit mund të mos jenë të mjaftueshme për të rikthyer trafikun normal. Irani mund të vazhdojë të përdorë raketa dhe dronë për të kërcënuar anijet, ndërsa SHBA-ja nuk mund të eliminojë çdo pikë të mundshme lëshimi apo çdo armë. “Do të jetë praktikisht e pamundur të goditet çdo raketë apo dron iranian, kështu që iranianët mund të vazhdojnë të ngacmojnë anijet dhe ta mbajnë ngushticën nën kërcënim për njëfarë kohe”, tha Plitsas. Ai tha se situata aktuale mund të vazhdojë, në mungesë të rikthimit të luftimeve në shkallë të gjerë, derisa presioni ndaj

Iranit të çojë në një marrëveshje të negociuar. Kjo e vendos Uashingtonin përballë një testi të vështirë. Objektivi ushtarak është mbrojtja e rrugës ujore, por operatorët tregtarë duhet gjithashtu të binden se rreziku i lundrimit përmes Hormuzit është ulur mjaftueshëm për të justifikuar rikthimin e trafikut të rregullt.

Jo një fazë e re e luftës

Jason Brodsky, drejtor i politikave në organizatën United Against Nuclear Iran, tha se sulmi ishte një sinjal se Uashingtoni nuk do të lejojë Iranin të përmbysë ato që ai i përshkroi si arritje amerikane gjatë javëve të fundit në garantimin e lirisë së lundrimit në Hormuz. “Besoje se sulmi i sotëm është një sinjal nga SHBA-ja se nuk do ta lejojë Iranin të përmbysë përpasimet amerikane të javëve të fundit në garantimin e lirisë së lundrimit në ngushticën e Hormuzit”, tha Brodsky për Radion Evropa e Lirë. Por, Brodsky paralajmëroi kundër paraqitjes së sulmit si fillimin e një faze krejtësisht të re të konfliktit. “Nuk është një ndryshim vendimtar drejt një faze të re të luftës”, tha ai. “Përkundrazi, është një kujtesë se SHBA-ja ka vullnetin për të garantuar sigurinë e ngushticës së Hormuzit”. Zhvillimi më i rëndësishëm mund të jetë reagimi i Iranit. Duke folur para raportimit për sulmet hakmarrëse të IRGC-së, Brodsky tha se pritej që Teherani të kundërpërgjigjej ndërsa po përballet me pasoja ekonomike dhe se politikëbërësit amerikanë e kuptojnë këtë dinamikë. “Se si do të përgjigjet SHBA-ja ndaj çdo sulmi iranian do të ketë rëndësinë më të madhe”, tha ai. “Do të nevojitet një përgjigje vendimtare amerikane për të demonstruar se SHBA-ja ka qëndrueshmërinë për ta

vazhduar bllokadën për aq kohë sa Irani refuzon t’iu nënshtrohet kërkesave amerikane”. Kjo mund të krijojë një cikël në të cilin Irani përpiquej t’u shkaktojë kosto forcave amerikane ose transportit detar pa u rikthyer në një luftë në shkallë të plotë, ndërsa Uashingtoni përgjigjet sa herë që vlerëson se veprimet iraniane kërcënojnë lundrimin.

Hormuzi i hapur, por trafiku rëndë i kufizuar

Ian Ralby, drejtues i kompanisë së sigurisë detare Auxilium Worldwide, tha se sulmi amerikan nënvizon se konflikti mes SHBA-së dhe Iranit mbetet i pazgjidhur. “Besoje se sulmi i sotëm tregon atë që çdo vëzhgues serioz e ka ditur gjatë gjithë kohës - se mes SHBA-së dhe Iranit vazhdon të ketë një konflikt të armatosur ndërkombëtar”, tha Ralby për Radion Evropa e Lirë. Ai tha se sulmi tregoi se ekzistojnë “një sërë çështjesh të pazgjidhura, për të cilat nuk ka asnjë afat të qartë për zgjidhjen e tyre”. Dobësimi i vazhdueshëm i transportit detar përmes Hormuzit e ilustron problemin. Ralby tha se trafiku është ndër më të ulëtit e regjistruar gjatë konfliktit, me rreth pesë anije në ditë që lëvizin në secilin drejtim dhe disa ditë pa asnjë anije. Për Ralby, kjo tregon se Uashingtoni mbetet “i pozicionuar, i gatshëm dhe i vullnetshëm për të përdorur forcën kundër Iranit – si në det, ashtu edhe në territorin e tij sovran – për të arritur objektivat e tij”. Por, veprimi ushtarak i vetëm nuk mund t’i eliminojë rreziqet me të cilat përballen operatorët tregtarë. Edhe një sulm që nuk e mbyll rrugën ujore mund t’i pengojë anijet, të rrisë kostot e sigurimit dhe t’i shtyjë kompanitë drejt rrugëve alternative. Prandaj, hapat e ardhshëm të Iranit do të jenë vendimtarë. Premtimi i Teheranit për të ndëshkuar agresorin erdhi pasi IRGC-ja raportoi viktima në sulmin në ishullin Larak, duke krijuar presion ndaj udhëheqësve iranianë për të treguar se sulmet amerikane do të kenë një çmim. Ralby paralajmëroi se çdo përshkallëzim mund të mos mbetet i kufizuar në Hormuz. Ai tha se rajoni ka pika të shumta të mundshme për përplasje dhe paralajmëroi se zhgënjimi me status quo-në mund ta shtyjë

njëren palë të veprojë në një mënyrë që të shkaktojë rikthimin e dhunës. “Situata në Hormuz nuk ka gjasa të zgjidhet së shpejti”, tha Ralby. “Ka njerëz me durim të shkurtër dhe fitila të shkurtër mes një numri aktorësh”. Irani ka sulmuar shpesh bazat amerikane në të gjithë rajonin, vuri në dukje Ralby, ndërsa përfshirja e Huthive dhe incidentet e piraterisë krijojnë mundësi të tjera për dhunë. Përshkallëzimi i ardhshëm mund të përhapet, sipas tij, “shumë përtej kufijve gjeografikë të ngushticës së Hormuzit”. Ai përmendi gjithashtu Libanin dhe Gazën si pika të tjera të nxehta, ku vazhdimi i dhunës mund ta shtyjë Iranin ose Huthit të kryejnë sulme në forma të reja. “Pra, kjo gjë mund të dalë më tej jashtë kontrollit në çdo moment”, tha Ralby.

Rriten pasojat ekonomike globale

Pasojat e një ndërprerjeje të zgjatur në Hormuz do të shtriheshin shumë përtej përbaljes ushtarake. Ralby tha se situata globale ekonomike po bëhet gjithnjë e më shqetësuese, ndërsa hemisfera veriore i afrohet dimrit dhe kërkesa për karburant për ngrohje pritet të rritet. Ai paralajmëroi se problemi mund të kalojë nga çmimet në të larta të energjisë të çështjet e furnizimit fizik dhe mungesat e mundshme, në varësi të ashpërsisë së dimrit. “Po afrohem gjithnjë e më shumë drejt periudhës së dimrit për hemisferën veriore, me kërkesën për naftë për ngrohje që do të nisë të rritet ndjeshëm në dy muajt e ardhshëm”, tha Ralby, duke ngritur shqetësime “jo vetëm për çmimin, por edhe për furnizimin dhe më pas për mungesat në përgjithësi”. Kina mund të shtojë një tjetër shtresë pasigurie. Ralby tha se Pekini ka qenë duke ulur artificialisht kërkesën e tij për naftë, por një rritje e përtërirë e konsumit kinez mund t’i çojë çmimet e naftës më lart dhe të thellojë pasojat ekonomike të përplases. Ai paralajmëroi se një presion i tillë mund t’i inkurajojë gjithashtu më shumë shtete të kryejnë transaksione me Kinën jashtë mekanizmave financiarë të bazuar në dollar, të cilët kanë ndihmuar në mbështetjen e ndikimit ekonomik amerikan për dekada.

PDK-ja DHE ALEANCA PARA QEVERISË: INSTITUCIONET DUHET TË ZHBLLOKOHEN

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 31 GUSHT - Deputetë të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe të Aleancës kanë vazhduar edhe të hënën aksionin para objektit të Qeverisë së Kosovës, duke kërkuar nga mazhoranca ta marrë përgjegjësinë për funksionalizimin e institucioneve dhe vazhdimin e procesit të konstituimit të Kuvendit. Aksionit i janë bashkuar edhe përfaqësues të institucioneve lokale, asamblistë dhe aktivistë politikë nga Skenderaj dhe Istogu. Të pranishmit janë mbledhur në orët e mëngjesit para objektit të qeverisë, duke kërkuar zhbllokimin e institucioneve dhe vazhdimin e procesit të konstituimit të Kuvendit. Nën kryetari i Skenderajt, Fadil Nura, tha se kanë dalë për t'i mbështetur deputetët të cilët, sipas tij, po mbrojnë rendin kushtetues dhe demokracinë në vend. "Sot jemi këtu për t'i mbështetur fuqishëm deputetët që janë vënë në mbrojtje të rendit kushtetues dhe demokracisë e cila po vazhdon të cenohet. Ne, si autoritete lokale dhe si pjesë integrale e sistemit kushtetues, vlerësojmë se kemi obligim, përtej bindjeve politike, t'i mbrojmë institucionet tona dhe t'i ndërtojmë ato", tha Nura.

Ai i bëri thirrje mazhorancës ta marrë përgjegjësinë dhe t'i themelojë institucionet e vendit. "Shfrytëzoj rastin që, në emër të komunës së Skenderajt, t'i bëj thirrje mazhorancës ta rishqyrtojë qëndrimin dhe ta marrë përgjegjësinë që ia kanë dhënë qytetarët, t'i themelojë institucionet e shtetit dhe të ecim përpara. Ne do të jemi krah deputetëve të Republikës së Kosovës që janë mbrojtës të sovranitetit, Kushtetutës dhe rendit kushtetues", u shpreh ai. Edhe kryetari i Degës së PDK-së në Istog, Ali Nimanaj, tha se kanë dalë për t'i mbështetur deputetët në kërkesat e tyre për mbrojtjen e rendit kushtetues dhe ligjeve të Kosovës. "Jemi sot këtu për t'u dhënë mbështetje deputetëve në kauzën e tyre për mbrojtjen e rendit kushtetues dhe ligjeve të Republikës së Kosovës. Njëkohësisht, i bëjmë thirrje mazhorancës dhe partisë që ka fituar zgjedhjet që sa më parë ta thërrasë seancën dhe ta vazhdojë konstituimin e institucioneve të Republikës së Kosovës, gjegjësisht të Kuvendit", tha Nimanaj. Sipas tij, gjendja politike ka ndikuar edhe në funksionimin e komunave, të cilat, siç ka thënë ai, po përballen me vështirësi në realizimin e projekteve kapitale. "Një prej problemeve kryesore është se komunat janë buzë kolapsit. Bazuar në vendimet që janë marrë për buxhetet

komunale, projektet kapitale që kanë qenë të planifikuara tashmë janë dëmtuar dhe nuk kanë mundësi të realizohen", deklaroi Nimanaj. Ai përmendi edhe problemet me të cilat po përballen fermerët në Istog, duke theksuar se dëmet nga vërshimet e viteve 2022 dhe 2023 ende nuk janë kompensuar. "Fermerët e komunës nga vij unë, që nga viti 2022 dhe 2023, pas vërshimeve dhe fatkeqësive natyrore, ende nuk janë kompensuar. Tash së fundmi edhe breshëri ka goditur fermerët e Istogut të cilët presin ndihmën e qeverisë", tha ai. Nimanaj kërkoj që institucionet të konstituohen dhe ta rifillojnë punën, duke paralajmëruar për vështirësitë që mund të paraqiten gjatë muajve të ardhshëm, veçanërisht në sektorin e energjisë. Ndërkaq deputeti i PDK-së, Mërgim Lushtaku, tha se çështja e zhbllokimit të institucioneve nuk është më vetëm çështje e deputetëve, por edhe e qytetarëve. "Falënderoj veçanërisht përfaqësuesit e Skenderajt dhe Istogut që kanë ardhur sot për të na mbështetur. Kjo kauzë nuk është më vetëm e përfaqësuesve në Kuvendin e Kosovës, por është edhe e të gjithë qytetarëve të vendit", tha Lushtaku. Sipas tij, cenimi i Kushtetutës dhe i shtetit prek drejtpërdrejt interesat e

qytetarëve. "Kur cenohet shteti dhe Kushtetuta, cenohet edhe interesi më i madh i qytetarëve. Prandaj, kur cenohet Kushtetuta dhe vetë shteti i Kosovës, na keni përballë, sepse kemi përgjegjësi që ta mbrojmë Kushtetutën dhe shtetin", deklaroi Lushtaku. Lushtaku kritikoi edhe atë që e quajti "normalizim" të problemeve të ndryshme në vend, duke përmendur energjinë, transportin hekurudhor dhe mungesën e barnave esenciale. "Është bërë normalitet shkelja e Kushtetutës dhe e ligjit. Është bërë normalitet edhe mosinvestimi në termocentrale dhe shitja apo importimi i energjisë nga Serbia. Është bërë normalitet edhe riparimi i vagonëve të trenit në Serbi. Është bërë normalitet, fatkeqësisht, edhe mostrajtimi dhe mosfurnizimi me barna esenciale për pacientët që vuajnë nga kanceri", tha ai. Lushtaku u shpreh se një gjendje e tillë nuk duhet të konsiderohet normale dhe paralajmëroi se PDK-ja dhe Aleanca do të vazhdojnë të kundërshtojnë, siç tha ai, shkeljet e Kushtetutës. "Për një të ri në Kosovë u bë normalitet që të mos mendojë se Kosova është vend ku mund të ketë perspektivë në të ardhmen. Këtë normalitet ne duhet ta luftojmë, sepse asgjë nuk është

normale në këtë rrjedhë", tha Lushtaku. Ai shtoi se protesta e sotme është simbolike, por paralajmëroi mobilizim më të madh nëse, sipas tij, vazhdon bllokada institucionale. "Mos ta konsiderojnë durimin tonë si frikë, sepse nuk frikësohemi aspak. Sot jemi këtu në formë simbolike me një numër më të vogël, ndërsa nesër mund të jemi edhe në rrugë", deklaroi Lushtaku. Ndërkaq, deputetja e Aleancës, Albana Bytyqi, kërkoj nga kryeministri në detyrë, Albin Kurti, të rikthehet në Kuvend dhe të vazhdojë procesi i formimit të institucioneve. "Kosova tash e dy vjet po përballlet me mungesë të institucioneve dhe me shumë shqetësime e sfida që kërkojnë zgjidhje. Ne duhet të shkojmë në parlament dhe këto probleme t'i zgjidhim aty ku është vendi dhe aty ku qytetarët na kanë dhënë besimin", tha Bytyqi. Ajo i bëri thirrje Kurtit të kthehet në Kuvend dhe ta vazhdojë procesin e konstituimit të institucioneve. "E ftoj edhe një herë Albin Kurtin të mos bëjë shaka me besimin e qytetarëve, të vijë në Kuvend, t'i krijojë institucionet dhe të vazhdojmë punën. Hajde në Kuvend, bëni institucionet dhe ta vazhdojmë punën", u shpreh Bytyqi.



LV-ja DHE LDK-ja PAJTOHEN QË BEKIM SEJDIU TË JETË KANDIDAT PËR PRESIDENT

MINUS NJË VOTË, AVDULLAH HOTI KUNDËR

Prof. dr. Bekim Sejdiu është emri për të cilin janë marrë vesh kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku dhe kryeministri në detyrë, Albin Kurti, në kuadër të diskutimeve për zgjedhjen e presidentit të Kosovës. Abdixhiku ka bërë me dije para medieve, pas takimit me Kurtin, se nga 9 korriku janë zhvilluar takime dhe diskutime të vazhdueshme për çështjen e presidentit. Ai ka thënë se sot po i japin republikës një zgjidhje të mbarë, të përgjegjshme dhe dinjitoze. Kjo kandidaturë ka shfaqur menjëherë pakënaqësi brenda LDK-së. Deputeti Avdullah Hoti ka thënë se nuk e përkrah këtë kandidaturë për president, jo për arsye personale, por për një parim politik dhe institucional

EPOKA E RE
Mal QORRAJ

PRISHTINË, 31 GUSHT - Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) janë pajtuar që Bekim Sejdiu të jetë kandidat për president të Kosovës. Marrëveshja u njoftua të hënën e 31 gushtit nga kreu i LDK-së, Lumir Abdixhiku, pas takimit me kreun e LV-së, Albin Kurti.

Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se sot po i japin republikës një zgjidhje të mbarë, të përgjegjshme dhe dinjitoze. Ai ka thënë se pas përfundimit të negociatave të gjata është i lumtur të njoftojë se Lidhja Demokratike e

Kosovës dhe Lëvizja Vetëvendosje do ta propozojnë bashkërisht profesor dr. Bekim Sejdiun kandidat për president të Republikës së Kosovës. "Ky është, para së gjithash, një lajm i mirë për Kosovën. Vendi ynë ka kaluar muaj të tërë në pasiguri politike dhe institucionale. Institucionet kanë mbetur të bllokuara, kohë e çmuar është humbur gjersa qytetarët, me të drejtë, kanë pritur nga ne që ta vendosim interesin e shtetit mbi llogaritë partiake. Pikërisht këtë kemi bërë. Emri i profesor Sejdiut u propozua nga të dyja palët, në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra. Kur interesi i Republikës vendoset

mbi interesin partiak, mund të gjenden njerëz dhe zgjidhje që bashkojnë. Në këtë pikë dua t'i falënderoj të dy ekipet diskutuese për mbështetjen në këtë proces; për përpjekjet konstruktive në një proces të vështirë dhe kompleks", ka thënë Abdixhiku. Ai ka shtuar se profesor Sejdiu është jurist i shquar, diplomat me përvojë të jashtëzakonshme në ShBA e Turqi që nga qeverisjet e para të LDK-së; ish-gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese dhe njohës i thellë i shtetit dhe i së drejtës. "Bekim Sejdiu e do Republikën, beson në Kushtetutën e saj dhe në orientimin tonë të palëkundur

euroatlantik; në miqësinë e përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Shtetar në bindje, me rrënjë në familje me ideale të larta kombëtare; mbi të gjitha, njeri me integritet, maturi dhe pavarësi - nga secila palë - virtyte që i duhen institucionit më të lartë përfaqësues të vendit. Prej tij presim të jetë president i Republikës dhe i të gjithë qytetarëve, jo përfaqësues i dy partive apo i një shumice të përkohshme. Presim ta mbrojmë rendin kushtetues, ta ruajmë unitetin e vendit dhe të veprojë me pavarësi, urtësi dhe përgjegjësi në çdo rrethanë. Presim që Kosovën ta përfaqësojë me dinjitet para aleatëve tanë; të mbrojmë pa asnjë lëkundje orientimin euroatlantik të shtetit; të jetë zë i arsyes në kohë përplasjesh dhe faktor bashkues kur dallimet politike e shoqërore bëhen të mëdha", është shprehur ai, duke shtuar se LDK-ja do ta mbështesë këtë marrëveshje me bindjen se shteti është më i rëndësishëm se çdo interes partiak. "Këtë e

kemi besuar gjithmonë. Këtë po e dëshmojmë edhe sot. Sot, përgjigja jonë ndaj jostabilitetit, kaosit e dyshimeve, është një Republikë me president dinjitoz; e me një LDK, që qëndron në origjinë - rugoviste e institucionaliste. Ajo jep individë me integritet; edhe kur nuk merr asgjë në kthim për veten. Sepse e do shtetin më shumë se sa veten", ka deklaruar Abdixhiku.

Në fjalën e tij para medieve, Sejdiu tha se e ka pranuar propozimin që të jetë kandidat për president, duke pasur parasysh kontekstin politik në të cilin ndodhet Kosova. "Kjo mua më bën të ndihem i nderuar, pra besimi që më kanë dhënë të dy partitë politike", ka thënë Sejdiu para medieve.

Bekim Sejdiu është profesor i së drejtës në Universitetin e Prishtinës dhe ish-gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Ai ka shërbyer edhe në diplomacinë kosovare, përfshirë si ambasador i Kosovës në Turqi dhe konsull i përgjithshëm në Nju-Jork.

BETOHET PËRBËRJA E RE E KQZ-së, ME NJË ANËTAR MË PAK - HAXHIU NUK IA EMËRON PDK-së EDHE NJË ANËTAR

Nëntë anëtarë të rinj të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) të Kosovës janë betuar të hënën para ushtrueses së detyrës së presidentit, Albulena Haxhiu. KQZ-ja parashihet t'i ketë njëmbëdhjetë anëtarë, në mesin e të cilëve përfshihet edhe kryetari i saj. Tashmë KQZ-ja ka një përbërje me një anëtar më pak. Ky anëtar do të duhej t'i takonte PDK-së, e cila duhej ta kishte edhe anëtarin e dytë brenda këtij institucioni, në përputhje me modelin strikt të përfaqësimit të grupeve parlamentare

EPOKA
ERE

Mal QORRJ

PRISHTINË, 31 GUSHT - Nëntë anëtarë të rinj të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) të Kosovës janë betuar para ushtrueses së detyrës së presidentit, Albulena Haxhiu. Betimin e dhanë Hysen Durmishi dhe Violeta Salihu nga Lëvizja Vetëvendosje!, Rashit Qalaj nga Partia Demokratike e Kosovës, Ilir Fetahu nga Lidhja Demokratike e Kosovës, Muharrem Nitaj nga Aleanca, Stefan Filipovic nga Lista Serbe, Yildiray Bayrami nga Partia Demokratike Turke e Kosovës, Delvir Tairi nga Koalicioni Vakati dhe Abedin Neziraj nga Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës. Në një postim në "Facebook", Haxhiu i uroi anëtarët për përgjegjësinë e re, duke theksuar se Kosova ka dëshmuar se ka një sistem zgjedhor të konsoliduar dhe ky standard duhet të ruhet e të forcohet vazhdimisht. "Sot, në ceremoninë zyrtare, dhanë betimin nëntë anëtarët e rinj të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të propozuar nga partitë politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Secilit prej tyre i urova suksese në këtë përgjegjësi të rëndësishme për garantimin e proceseve demokratike në vend. Kosova ka dëshmuar se ka një sistem zgjedhor të

konsoliduar dhe ky standard duhet të ruhet e të forcohet vazhdimisht", ka shkruar Haxhiu.

KQZ-ja parashihet t'i ketë njëmbëdhjetë anëtarë, në mesin e të cilëve përfshihet edhe kryetari i saj - aktualisht Kreshnik Radoniqi.

Sipas Ligjit për Zgjedhjet në Kosovë, gjashtë anëtarë emërohen nga gjashtë grupet më të mëdha parlamentare në Kuvend, kurse katër anëtarë të tjerë emërohen nga grupet parlamentare të komuniteteve joshumicë.

Nëse ka më pak se gjashtë grupe parlamentare, grupet më të mëdha mund të emërojnë edhe anëtarë shtesë.

Nga LV-ja sot u betuan dy anëtarë, por një tjetër anëtar shtesë - e që i bie të jetë i dhjetë - e që i takon PDK-së nuk u emërua nga u.d presidentja Haxhiu.

Përplasjet për anëtarin e dhjetë të KQZ-së

Deri më tani, ky institucion kishte funksionuar me një anëtar më pak, pasi procesi i emërimit ishte shoqëruar me paqartësi lidhur me përfaqësimin e partive politike në këtë institucion, veçanërisht mes Lëvizjes Vetëvendosje dhe Partisë Demokratike të Kosovës. Ish-presidentja Vjosa Osmani, në mars, iu drejtua Gjykatës



Kushtetuese për të kërkuar sqarim lidhur me përbërjen e KQZ-së, pasi LV-ja kishte propozuar tre kandidatë, ndërsa PDK-ja dy.

Gjykata Kushtetuese, më 30 mars, e shpalli të papranueshme kërkesën e Osmanit, pa vendosur në themel se cilës parti i takonte ulësja e kontestuar.

Më 8 prill, disa media raportuan se PDK-ja i kishte dërguar letër ushtrueses së detyrës së presidentit Albulena Haxhiu, duke kërkuar emërimin e anëtarit të dytë të PDK-së në KQZ.

Kjo parti i ishte referuar nenit 139, paragrafit 4 të Kushtetutës, duke argumentuar se, duke pasur parasysh përbërjen e atëhershme të Kuvendit, PDK-

së i takonin dy përfaqësues në KQZ.

Pozitën e anëtarit të dhjetë në KQZ e kishte kërkuar edhe LV-ja.

Deputeti Artan Abrashi, gjatë një adresimi në Kuvend në muajin prill, i kishte kërkuar Haxhiut të emërojë anëtarin e tretë të LV-së në KQZ, duke argumentuar se LV-ja, si grupi më i madh parlamentar, e ka këtë të drejtë.

DnV i bën thirrje u.d presidentes Haxhiu ta kompletojë KQZ-në me anëtarin e njëmbëdhjetë

Demokracia në Veprim (DnV) vlerëson se u.d. presidentja Albulena Haxhiu, me

emërimin e anëtarëve të rinj të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk e ka përmbyllur përbërjen e plotë të këtij institucioni. KQZ-ja ka mbetur me 10 nga 11 anëtarët që parashihen me Kushtetutë. Për DnV-në, argumenti se KQZ-ja mund të funksionojë edhe me 10 anëtarë nuk mund të shërbejë si arsye për moskompletimin e saj. "Kushtetuta e ka përcaktuar përbërjen e KQZ-së dhe respektimi i saj nuk mund të varet nga vlerësimi nëse mungesa e një anëtarë e pengon apo jo punën e përditshme. Normalizimi i një praktike të tillë krijon precedent të dëmshëm, dobëson sigurinë juridike dhe cenon besimin në institucionin që ka përgjegjësinë kryesore për administrimin e zgjedhjeve. Prandaj, Demokracia në Veprim i bën thirrje u.d. presidentes Albulena Haxhiu që pa vonesë ta përmbyllë procesin dhe ta kompletojë KQZ-në me anëtarin e njëmbëdhjetë. Emërimi duhet të bëhet në përputhje me modelin strikt të përfaqësimit të grupeve parlamentare, të zbatuar në praktikën institucionale deri në ciklin e fundit, ku grupet përfaqësohen fillimisht në mënyrë të barabartë dhe vendet shtesë plotësohen sipas radhës së grupeve më të mëdha", thuhet në reagimin e DnV-së.

Ushtruesja e detyrës së presidentit të Kosovës, Albulena Haxhiu, ka thënë se mirëpret marrëveshje për presidentin.

Haxhiu, që vjen nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosjes, e cilësoi si "hap shumë të rëndësishëm" drejt tejkalimit të ngërçit dhe funksionalizimit të plotë të institucioneve. "Tani është me rëndësi që ky proces të përmbyllet në Kuvend, me përgjegjësinë që kërkon momenti dhe interesi i Republikës", shkroi ajo në rrjetet sociale.

Pas njoftimit për kandidimin e Sejdiut, ish-presidentja Vjosa Osmani, e cila ka marrë pjesë në të gjitha raundet e negociatave mes LV-së dhe LDK-së për president, ka vlerësuar figurën e Sejdiut. Osmani ka thënë se Sejdiu përfaqëson seriozitetin, integritetin dhe vizionin që kërkon posti i kreut të shtetit. Sipas saj, Sejdiu i njej sfidat e Kosovës, duke kërkuar mbështetjen e deputetëve për të. "Një profesionist i

dëshmuar, një njeri me integritet dhe një figurë që e njej nga afër shtetin, institucionet dhe sfidat e Kosovës. Për mua, ai është gjithashtu një bashkëpunëtor i dëshmuar, me të cilin kam pasur nderin të bashkëpunoj për 25 vite, përfshirë në kabinetin tim gjatë mandatit tim si presidente, si dhe ta njoh nga afër përkushtimin, karakterin dhe përgjegjësinë e tij. Në fund, vendimi i takon përfaqësuesve të zgjedhur të Republikës dhe përgjegjësia për këtë vendim është historike. Ta bëjmë këtë zgjedhje duke menduar për Kosovën që duam të ndërtojmë, për interesin shtetëror, për stabilitetin institucional, për fuqizimin e aleancës euroatlantike e për demokracinë", ka shkruar Osmani.

Partia e Kurtit i fitoi 53 mandate në zgjedhjet e qershorit. Së bashku me partitë e komuniteteve joshumicë, i ka votat e mjaftueshme prej të paktën 61 sosh për të konstituuar

Avdullah Hoti nuk e përkrah Bekim Sejdiun për president

Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) janë pajtuar që Bekim Sejdiu të jetë kandidat për president të Kosovës. Marrëveshja u njoftua sot nga kreu i LDK-së, Lumir Abidhiku, pas takimit me kreun e LV-së, Albin Kurti.

Ish-kryeministri, aktualisht deputet i LDK-së, Avdullah Hoti, ka reaguar në "Facebook" se nuk e përkrah këtë kandidaturë për president të Republikës së Kosovës, jo për arsye personale, por për një parim politik dhe institucional. Sipas tij, presidenti i Republikës duhet të jetë

figurë unifikuese, e cila ndërton konsensus përtej interesave partiake dhe përfaqëson interesin e përgjithshëm të qytetarëve. "Në vlerësimin tim, kjo kandidaturë nuk e përmbush këtë kriter", ka shkruar ai. Hoti ka thënë se njëkohësisht kjo kandidaturë nuk pasqyron interesat politike dhe parimore të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe elektoratit të saj. "Përkundrazi, mënyra se si është imponuar kjo zgjidhje krijon përshtypjen se LDK ka penguar edhe kandidatura të tjera politike, vetëm për t'i hapur rrugë një kandidature që, në thelb, është po ashtu politike. LDK

duhet të ketë një qëndrim të qartë, të pavarur dhe të përgjigjshëm. Nuk mund të mbështesim një kandidaturë vetëm për hir të një marrëveshjeje politike, nëse ajo nuk përfaqëson parimet, interesat dhe pritjet e elektoratit të LDK-së. Kjo nuk është çështje individësh. Është çështje e parimeve, identitetit politik dhe përgjegjësisë që kemi ndaj votuesve tanë. Zoti e bekoftë Lidhjen Demokratike të Kosovës!", ka shkruar Hoti. Bekim Sejdiu kishte qenë gjyqtar raportues në rastin kur Gjykata Kushtetuese e rrëzoi qeverinë e udhëhequr prej Hotit në vitin 2020.

Kuvendin dhe krijuar Qeverinë e re. Megjithatë, që votimi për presidentin e ri të Kosovës të jetë i vlefshëm

kërkohet prania e 80 deputetëve në Kuvendin me 120 vende. Së bashku me 18 mandatet e LDK-së, janë të

paktën 81 vota, mjaftueshëm për votimin e presidentit të ri, nëse të paktën 80 prej tyre do të qëndrojnë në sallë.

DËNOHEN DY TË AKUZUAR PËR BARRIKADAT NË VERI, PËR KATËR TË TJERË GJYQI NIS MË 15 SHTATOR

PRISHTINË, 31 GUSHT - Gjykata Themelore në Prishtinë e ka dënuar Dushan Dobraqin me një vit burgim dhe Millosh Radosavljeviqin me nëntë muaj burgim për vendosjen e barrikadave në Zveçan, në veriun e Kosovës, më 2022. Ndaj tyre ishte veçuar procedura gjyqësore paraditen e së hënës, pasi gjyqtari kishte njoftuar se kishin arritur marrëveshje për pranim fajësie me Prokurorinë Speciale. Millosh Radosavljeviq u shpall fajtor për veprat penale “Bashkimi në veprimtari kundërkushtetuese me qëllim të sulmit kundër rendit kushtetues”. Për të njëjtën vepër dhe për “Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare” u shpall fajtor edhe Dobraq. Për veprën e parë ai u dënua me 6 muaj burgim, kurse për të dytën u dënua me 6 muaj burgim, raporton Betimi për Drejtësi. Ndërkaq është shtyrë për 15 shtator seanca gjyqësore ndaj katër të akuzuar të tjerë për vendosjen e barrikadave në veri të Kosovës më 2022, pasi në seancën fillestare të caktuar për këtë të hënë mungoi i akuzuari Nenad Orloviq. Gjykatësi i rastit, Rrahman

Beqiri, tha se në seancë mungon i akuzuari Nenad Orloviq, për të cilin gjykata ka përsëritur urdhërarrestin. Ai bëri me dije se, sipas raportit të policisë të datës 27 gusht 2026, zyrtarët policorë kanë shkuar për ta ekzekutuar urdhërarrestin, por Orloviq nuk është gjetur në vendbanim. Fqinjët e tij kanë deklaruar se ai jeton në Serbi. Ndërkaq, u veçua procedura për të akuzuarit Millosh Radosavljeviq dhe Dushan Drobaq, pasi kanë arritur marrëveshje me Prokurorinë për pranim të fajësisë, raporton Betimi për Drejtësi. Dushan Maksimoviq, Nemanja Jolloviq, Sërgjan Vuçiniq dhe Nenad Orloviq ngarkohen me veprën penale kundër rendit kushtetues për vendosje të barrikadave në veri të Kosovës më 2022. Aktakuza ndaj tyre u ngrit më 26 qershor 2026. Ata dyshohen se më 10 dhjetor 2022 kishin vendosur barrikada në rrugët e komunave veriore të Kosovës, të banuara me shumicë serbe. Barrikadat ishin larguar më 29 dhjetor të po atij viti. Të akuzuarit, tha Prokuroria, dyshohet se kishin bllokuar rrugët kryesore me mjete të forta, përfshirë kamionë të mbushur me zhavorr, ekskavatorë,



autoambulanca, autobusë dhe automjete të tjera.

Çfarë kishte ndodhur dhjetorin e vitit 2022 në veri?

Më 6 dhjetor të vitit 2022 në zyrat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në Mitrovicë të Veriut ishin hedhur dy mjete shpërthyes, por vetëm njëri kishte shpërthyer. Zyrtarët zgjedhorë në atë kohë po

organizonin mbajtjen e zgjedhjeve lokale në veri të Kosovës pas tërheqjes së kryetarëve serbë në katër komunitet në veri që vinin nga Lista Serbe - partia kryesore e serbëve që gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar - në shenjë pakënaqësie ndaj një vendimi të Qeverisë së Kosovës për rirregjistrimin e makinave me targa serbe në ato RKS - Republika e Kosovës. Si pasojë e tensioneve, votimet u shtynë për prillin e vitit pasues.

Për shkak të sulmit ndaj zyrave të KQZ-së, autoritetet kishin arrestuar ish-pjesëtarin e Policisë së Kosovës, Dejan Pantiq, më 9 dhjetor në pikën kufitare të Jarinjës, e cila e lidh Kosovën me Serbinë. Arrestimi i tij rriti edhe më shumë tensionet me serbët lokalë që më pas ngritën barrikada. Në atë kohë Serbia kishte vendosur në gatishmëri ushtrinë dhe kishte rritur pranimin ushtarak në vijën kufitare me Kosovën, përkatësisht në Rashkë.

ZKA: SISTEMI ARSIMOR NUK SIGURON ENDE MBËSHTETJE TË BARABARTË DHE TË QËNDRUESHME PËR NXËNËSIT ME NEVOJA TË VEÇANTA

PRISHTINË, 31 GUSHT - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka publikuar raportin e auditimit të performancës “Mbështetja e Nxënësve me Nevoja të Veçanta në Shkollat Filllore dhe të Mesme të Ulëta në Kosovë” për periudhën 2022-2022, me fokus në funksionimin e mekanizmave për identifikimin, vlerësimin dhe ofrimin e mbështetjes së nevojshme për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Subjekt i këtij auditimi kanë qenë Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA) në komunën e Prishtinës, Pejës dhe Mitrovicë, si dhe 10 shkolla publike. Rezultatet e auditimit tregojnë



se sistemi arsimor nuk siguron ende mbështetje të barabartë, të qëndrueshme dhe të bazuar në nevojat reale të nxënësve. Ekipet vlerësuese komunale nuk kanë funksionuar në

mënyrë të qëndrueshme, ndërsa kapacitetet profesionale dhe mbështetëse në shkolla, përfshirë asistentët, mësuesit mbështetës, psikologët dhe pedagogët nuk janë të

mjaftueshme dhe shpërndarja e tyre nuk mbështetet në analiza të dokumentuara të nevojave. Po ashtu, auditimi ka evidentuar mangësi në monitorimin dhe koordinimin institucional. Të dhënat për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në Sistemin për Menaxhimin e Informatave në Arsim (SMIA) kanë shfaqur mospërputhje me gjendjen e evidentuar në terren, ndërsa në disa raste mungesa e mbështetjes institucionale është kompensuar nga prindërit përmes angazhimit të asistentëve privatë. Lidhur me këtë auditim, Auditorja e Përgjithshme Vlora Spanca theksoi se arsimi gjithëpërfshirës nuk

nënkupton vetëm përfshirjen e nxënësve në shkollë, por sigurimin e mbështetjes së duhur që u mundëson atyre ta zhvillojnë potencialin dhe të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në procesin mësimor. Znj. Spanca tha se rezultatet e auditimit tregojnë se nevojitet një qasje më e koordinuar dhe e bazuar në nevojat reale të nxënësve në mënyrë që mbështetja të jetë e qasshme dhe në kohë për secilin nxënë. Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka dhënë 14 rekomandime me qëllim të përmirësimit të funksionimit të ekipeve vlerësuese, planifikimit të kapaciteteve mbështetëse, cilësisë së të dhënave dhe monitorimit institucional.

Fillojnë punën 37 zyrtarë të rinj në gjyqësorin e Kosovës

PRISHTINË, 31 GUSHT - Pas përfundimit me sukses të procedurave ligjore të rekrutimit dhe mbylljes së afatit për ankesa, të hënë janë nënshkruar aktet e emërimit për 37 zyrtarë të rinj në administratën e sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës. Struktura e të emëruarve përfshin: 13 zyrtarë ligjorë, 6

zyrtarë për përkthime, 1 zyrtar për shpenzime, 1 zyrtar për të hyra gjyqësore, 2 zyrtarë të logistikës, 5 zyrtarë për teknologji informative, 1 zyrtar për statistika, 1 zyrtar i personelit, 2 zyrtarë për transport, 3 asistent për shërbime të sigurisë dhe 2 asistent teknik të kontrollit të objektit.

Këshilli mbetet i përkushtuar për përmbushjen e detyrimeve të tij ligjore dhe krijimin e kushteve të nevojshme për funksionimin efikas të gjykatave, duke siguruar që proceset e rekrutimit dhe përzgjedhjes së stafit të zhvillohen në përputhje me parimet e ligjshmërisë, transparencës, objektivitetit dhe meritokracisë.



Maqedonci në Turqi merr pjesë në diplomimin e pesë kadetëve nga Kosova

PRISHTINË, 31 GUSHT - Ministri në detyrë i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka marrë pjesë në ceremoninë e diplomimit të kadetëve të Akademisë Ushtarake të Forcave të Armatosura të Turqisë, në kuadër të Ditës së Fitores së Republikës së Turqisë.

Në ceremoninë e mbajtur në Turqi, diplomuan edhe pesë kadetë nga Kosova, të cilët përfunduan me sukses

studimet ushtarake në këtë akademi.

Maqedonci ka bërë me dije se gjatë ceremonisë ka takuar presidentin e Turqisë, Recep Tayyip Erdoğan, si dhe ministrin e Mbrojtjes Kombëtare, Yaşar Güler, të cilëve ua ka përcjellë urimet me rastin e Ditës së Fitores.

Ai ka përgëzuar pesë kadetët nga Kosova për përkushtimin, disiplinën dhe suksesin e

arritur gjatë studimeve, duke u uruar karrierë të suksesshme në shërbim të vendit.

Sipas Maqedoncit, marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Turqisë në fushën e mbrojtjes janë të rëndësishme, ndërsa bashkëpunimi në edukimin dhe përgatitjen e kuadrove të reja ushtarake është një nga shembujt konkretë të këtij bashkëpunimi.



EKSPOZITA ‘NGJYRAT E LIRISË’ HAPET NË PRISHTINË, ARTI NË SHËRMBIM TË KUJTESËS DHE HISTORISË SË LUFTËS SË UÇK-SË

PRISHTINË, 31 GUSHT - Platforma qytetare “Liria ka Emër” ka hapur në FLORI Gallery, në “Prishtina Mall”, ekspozitën “Ngjyrat e Lirisë”, një aktivitet artistik kushtuar luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,

sakrificës për liri dhe kujtesës kolektive.

Në ekspozitë janë paraqitur vepra të piktorëve, skulptorëve dhe artistëve të medimeve të ndryshme, të cilët përmes krijimtarisë së tyre kanë

trajtuar luftën e UÇK-së, sakrificën, viktimat dhe pasojat e luftës.

Në ceremoninë e hapjes, në emër të platformës “Liria ka Emër”, foli Eliza Hoxha, e cila theksoi rëndësinë e artit si një prej mënyrave më të fuqishme për ta ruajtur dhe përcjellë kujtesën historike të brezave të rinj. “Liria jonë ka një histori, ka emra, ka sakrificë dhe ka kujtesë. Përmes artit, kjo histori merr një gjuhë tjetër, por mesazhi mbetet i njëjtë: liria që e gëzojmë sot është ndërtuar mbi sakrificën e shumë brezave dhe ajo duhet të kujtohet, të nderohet dhe t’u përcillet brezave që vijnë,” tha Hoxha.

Ajo theksoi se ekspozita “Ngjyrat e Lirisë” synon ta sjellë historinë e luftës çlirimtare edhe përmes perspektivës së artistëve, duke e bërë artin



dëshmi të kujtesës kolektive. Platforma “Liria ka Emër” falënderoi artistët që i janë bashkuar ekspozitës, FLORI Gallery për mikpritjen dhe të gjithë qytetarët që morën pjesë në hapjen e saj.

Ekspozita është pjesë e aktiviteteve të platformës “Liria ka Emër”, me synimin që përmes artit, kulturës dhe angazhimit qytetar të ruhet dhe të përcillet historia e luftës çlirimtare dhe vlera e lirisë.

PRISHTINA DO TË KRIJOJË NDËRMARRJE TË RE PUBLIKE KOMUNALE PËR PASTRIMIN

PRISHTINË, 31 GUSHT - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se kryeqyteti do të krijojë një ndërmarrje të re publike komunale për pastrimin, me qëllim përmirësimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave.

Rama ka thënë se aktualisht Prishtina bart barrën kryesore të Kompanisë Rajonale “Pastrimi”, në të cilën përfshihen edhe Obiliqi, Fushë-Kosova, Lipjani, Podujeva dhe Drenasi. Sipas tij, sistemi aktual nuk po arrin t’u përgjigjet me nevojave të kryeqytetit. “Që nga viti 2024 Hekuran Murati nuk e ka nënshkruar marrëveshjen me



KfW-në për investimin prej 74.1 milionë eurosh në sistemin e pastrimit dhe menaxhimit të mbeturinave. Kryeqyteti i ka përmbushur obligimet e veta.

Dokumentet janë tashmë publike. Procesi ka mbetur i bllokuar për një nënshkrim”, ka deklaruar Rama.

Ai e ka akuzuar qeverinë se koston

e këtij bllokimi po e paguajnë qytetarët e Prishtinës. Rama ka bërë me dije se vendimi për krijimin e ndërmarrjes së re është marrë pas një takimi me kryetarët e komunave pjesë e Kompanisë Rajonale “Pastrimi”, menaxhmentin dhe punëtorët e kompanisë.

“Do ta krijojmë ndërmarrjen e re publike komunale të pastrimit të kryeqytetit. Do të krijojmë kapacitetet tona, të dedikuara për Prishtinën, për një sistem pastrimi funksional, efikas dhe të qëndrueshëm”, ka thënë ai. Kryetari i Prishtinës ka siguruar punëtorët e kompanisë “Pastrimi” se askush nuk do të mbetet pa

punë. “Askush nuk do të mbetet pa punë. Ata do të jenë pjesë e zgjidhjes dhe e sistemit të ri që po ndërtojmë”, ka deklaruar Rama. Sipas tij, në bazë të Ligjit për Kryeqytetin, për krijimin e ndërmarrjes së re nuk nevojitet pëlqimi i qeverisë. “Qytetarët nuk mund të presin dhe Prishtina nuk mund të mbahet peng. Kur një zgjidhje bllokohet, ne kemi përgjegjësi të krijojmë një tjetër”, ka thënë Rama. Ai ka shtuar se procesi do të vazhdojë me synimin që kryeqytetit t’i sigurohen kapacitetet e nevojshme për pastrimin dhe qytetarëve një Prishtinë më të pastër.

Edhe në Rahovec nisi “Ora e Pritjes” për çlirimtarët

PRISHTINË, 31 GUSHT - Edhe komuna e Rahovecit ka lansuar “Orën e Pritjes”, duke nisur numërimin mbrapsht drejt 16 shtatorit, në mbështetje të

Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, që po gjykohej në Hagë. Aktiviteti është pjesë e nismës së platformës qytetare “Liria ka

Emër”, e cila po zhvillohet nëpër komunat e Kosovës nën moton “Kosova po pret”.

Rikujtojmë se më 12 shtator nga ora 14:00 në Sheshin

“Skënderbeu”, në Prishtinë do të mbahet Marshi për Liri, në prag të vendimit të 16 shtatorit për heronjtë tanë të luftës dhe paqes.



AKB: PESË SHTETE ZOTËROJNË RRETH 62% TË NAFTËS SË PROVUAR BOTËRORE, MËSIMI PËR KOSOVËN

PRISHTINË, 31 GUSHT - Aleancës Kosovare e Bizneseve (AKB) ka realizuar studimin e parë në Kosovë për burimet e naftës në nivel global, kur nafta vazhdon të mbetet një nga pasuritë më të rëndësishme strategjike të ekonomisë botërore.

Pavarësisht zhvillimit të energjisë së gjelbër dhe tranzicionit energjetik, nafta dhe derivatet e saj vazhdojnë të kenë rol vendimtar në transport, industri, aviacion, petrokimi dhe në ekonominë globale.

Ky studim i Aleancës Kosovare të Bizneseve vjen në një kohë kur krizat energjetike, konfliktet gjeopolitike dhe luhatjet në tregun e naftës kanë prekur tregjet globale, Kosovën dhe rajonin më shumë se kurrë më parë.

Rritja e pasigurisë për furnizim dhe luhatjet e çmimeve të naftës dhe derivateve kanë dëshmuar se siguria energjetike nuk është më vetëm çështje ekonomike, por edhe çështje strategjike dhe e sigurisë kombëtare.

Pikërisht për këtë arsye, AKB-ja ka realizuar këtë studim për të analizuar pasurinë globale të naftës, fuqinë e shteteve që kontrollojnë rezervat dhe rëndësinë që kanë rafinimi, teknologjia dhe diversifikimi i burimeve të furnizimit për ekonominë moderne. Studimi i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB) tregon se pasuria botërore e naftës është jashtëzakonisht e përqendruar: vetëm pesë shtete zotërojnë rreth 62% të rezervave të provuara botërore të naftës.

Megjithatë, ekziston një dallim shumë i rëndësishëm ekonomik: Të zotërosh naftën nuk do të thotë domosdoshmërisht të fitosh më shumë prej saj! “Vlera më e madhe ekonomike krijohet përgjatë zinxhirit të përpunimit të naftës bruto në benzinë, dizel, karburant për aviacion, gaz, lubrifikantë, asfalt, plastikë dhe qindra produkte të tjera të industrisë petrokimike”, thuhet në këtë studim.

Pesë fuqitë më të mëdha të rezervave të naftës në botë

Renditja e shteteve dhe rezervat e provuara. Pjesa e rezervave botërore:

- Venezuela| 303.0 miliardë fuçi| 17.17%
 - Arabia Saudite| 267.2 miliardë fuçi| 15.14%
 - Iranij| 208.6 miliardë fuçi| 11.82%
 - Kanadaja| 163.1 miliardë fuçi| 9.24%
 - Iraku| 145.0 miliardë fuçi| 8.22%
- Gjithsej: rreth 1.087 trilionë fuçi naftë. Këto pesë shtete zotërojnë së bashku rreth 61.6% të rezervave të provuara botërore të naftës.

Kjo do të thotë se më shumë se gjysma e pasurisë strategjike të naftës në botë është e përqendruar vetëm në pesë shtete.

Venezuela, fuqia më e madhe e rezervave në botë

Venezuela renditet në vendin e parë në botë për rezervat e provuara të naftës. Me rreth 303 miliardë fuçi, ajo zotëron mbi 17% të rezervave botërore. Megjithatë, Venezuela është shembulli më i mirë se rezervat e mëdha nuk garantojnë automatikisht prodhim të madh dhe pasuri ekonomike. Problemet politike, mungesa e investimeve dhe vështirësitë në industrinë energjetike kanë bërë që potenciali i saj të mos shfrytëzohet plotësisht.



Arabia Saudite, një nga fuqitë më të mëdha energjetike në botë

Arabia Saudite zotëron rreth 267.2 miliardë fuçi, ose mbi 15% të rezervave botërore. Por fuqia e saj nuk qëndron vetëm te rezervat.

Arabia Saudite ka ndërtuar një nga sistemet më të fuqishme në botë për: nxjerrjen e naftës; eksportimin; rafinimin; industrinë petrokimike; kontrollin strategjik të tregjeve energjetike. Pikërisht ky kombinim e ka bërë Arabinë Saudite një nga fuqitë më të rëndësishme energjetike dhe ekonomike në planet.

Irani, gjigant energjetik me potencial të jashtëzakonshëm

Irani zotëron rreth 208.6 miliardë fuçi naftë, që përfaqësojnë rreth 11.82% të rezervave botërore. Përveç naftës, Irani ka gjithashtu rezerva shumë të mëdha të gazit natyror. Pozita e tij gjeografike pranë Gjirit Persik dhe rrugëve më të rëndësishme të transportit të energjisë e bën atë një fuqi të madhe gjeopolitike. Megjithatë, potenciali i plotë ekonomik është kufizuar për vite nga sanksionet dhe tensionet ndërkombëtare.

Kanadaja, fuqia energjetike e Amerikës së Veriut

Kanadaja zotëron rreth 163.1 miliardë fuçi, ose 9.24% të rezervave botërore. Pjesa më e madhe e këtyre rezervave lidhet me rërat naftëmbajtëse. Kanadaja ka një avantazh shumë të rëndësishëm: kombinimin e rezervave të mëdha, teknologjisë moderne, stabilitetit institucional dhe qasjes në tregjet e mëdha të Amerikës së Veriut. Kjo e bën atë një nga fuqitë më të rëndësishme energjetike globale.

Iraku, një gjigant i pasurisë nëntokësore Iraku renditet në vendin e pestë në botë me rreth 145 miliardë fuçi naftë, ose 8.22% të rezervave botërore. Iraku ka potencial të jashtëzakonshëm për të qenë një nga prodhuesit dhe eksportuesit më të fuqishëm të naftës në botë. Megjithatë, zhvillimi i plotë i këtij potenciali është ndikuar nga luftërat, krizat politike dhe problemet infrastrukturale.

Por kush përfiton më shumë nga nafta?

Këtu qëndron dallimi më i madh

ekonomik. Vlera e naftës nuk përfundon në momentin kur ajo nxirret nga toka. Një fuçi naftë bruto mund të përpunohet në: benzinë; dizel; karburant për aviacion; gaz të lëngshëm; vajra lubrifikues; asfalt; plastikë; produkte kimike; materiale industriale; qindra produkte të tjera.

Prandaj, vendet që kanë ndërtuar rafineri moderne dhe industri të zhvilluar petrokimike krijojnë vlerë të shtuar dhe mund të përfitojnë shumë më tepër përgjatë zinxhirit ekonomik të naftës.

Nafta është pasuri, por rafinimi dhe industria sjellin vlerën e shtuar

Në ekonominë moderne, fuqia nuk matet vetëm me numrin e fuçive që ndodhen nën tokë. Fuqia matet edhe me: kapacitetin për nxjerrje; kapacitetin për rafinim; teknologjinë; industrinë petrokimike; kapacitetet e depozitimit; rrjetin e transportit; qasjen në tregjet ndërkombëtare. Kjo është arsyeja pse disa vende që nuk kanë rezervat më të mëdha të naftës janë bërë fuqi të mëdha në industrinë e përpunimit dhe të derivateve.

Fuqia e rafinerive dhe derivateve

Rafineritë moderne shndërrojnë naftën bruto në produkte me vlerë shumë më të lartë ekonomike.

Vende si: Shtetet e Bashkuara të Amerikës; Kina; India; Koreja e Jugut; Arabia Saudite; kanë ndërtuar kapacitete të jashtëzakonshme të rafinimit dhe përpunimit të naftës. Një nga komplekset më të mëdha të rafinimit në botë është Jamnagar në Indi, i cili përfaqëson fuqinë e industrisë moderne të përpunimit të naftës. Mesazhi ekonomik është i qartë: Kush zotëron rezervën, zotëron pasurinë natyrore.

Kush kontrollon rafinimin, teknologjinë dhe tregun, krijon vlerë të shtuar dhe mundësi për përfitime më të mëdha ekonomike.

Mësimi për Kosovën

Kosova nuk disponon rezerva të konsiderueshme të naftës dhe mbetet pothuajse tërësisht e varur nga importi i derivateve. Kjo e bën ekonominë dhe qytetarët e Kosovës të ndjeshëm ndaj: rritjes së çmimeve ndërkombëtare; krizave gjeopolitike; konflikteve dhe luftërave; ndërprerjeve të rrugëve tregtare; mungesës së furnizimit; luhatjeve të tregjeve ndërkombëtare.

Për këtë arsye, Aleanca Kosovare e Bizneseve konsideron se Kosova duhet të ndërtojë një strategji shumë më serioze për sigurinë energjetike.

AKB kërkon:

- Rritjen e rezervave strategjike të derivateve
- Kosova duhet të ketë kapacitete të mjaftueshme depozitimi për të përballuar krizat dhe ndërprerjet e furnizimit.
- Diversifikimin e burimeve të furnizimit
- Varësia nga një numër i kufizuar furnizuesish ose rrugësh tregtare krijon rrezik ekonomik dhe strategjik.
- Investime në infrastrukturën energjetike
- Depozitat, terminalët dhe infrastruktura e transportit duhet të trajtohen si çështje e sigurisë kombëtare.
- Zhvillimin e energjisë së ripërtëritshme
- Energjia solare, energjia e erës dhe burimet e tjera vendore duhet të zhvillohen për të ulur varësinë energjetike dhe ekonomike nga importi.
- Bashkëpunimin rajonal për sigurinë energjetike
- Kosova duhet të rrisë bashkëpunimin me SHBA-në, Shqipërinë dhe vendet e rajonit për krijimin e korridoreve më të sigurta energjetike dhe tregtare, si dhe për mundësinë e furnizimit me gaz amerikan.

Përfundimi i AKB-së

Venezuela, Arabia Saudite, Irani, Kanadaja dhe Iraku zotërojnë rreth 62% të rezervave të provuara botërore të naftës.

Por studimi i AKB-së nxjerr një përfundim të rëndësishëm: Pasuria nëntokësore nuk është e njëjtë me fuqinë ekonomike.

Fuqia e vërtetë ekonomike krijohet nga kombinimi i: Rezervave + Teknologjisë + Rafinimit + Industrisë petrokimike + Tregut.

Vendet që përpunojnë naftën dhe e shndërrojnë atë në qindra produkte me vlerë të shtuar krijojnë përfitime shumë më të mëdha ekonomike.

Mesazhi i AKB-së është i qartë: Nafta është pasuri natyrore. Rafinimi është fuqi industriale. Derivatet janë vlerë ekonomike. Siguria e furnizimit është interes kombëtar.

Për Kosovën, sfida nuk është të zotërojë naftë që nuk e ka, por të ndërtojë një sistem modern të sigurisë së furnizimit, depozitimit strategjik, diversifikimit të burimeve dhe zhvillimit të energjisë vendore.

Njëkohësisht, Kosova duhet të punojë për forcimin e lidhjeve rajonale energjetike dhe për mundësinë e kyçjes në projekte të gazit natyror dhe korridoreve ndërkombëtare të furnizimit, përfshirë mundësitë që krijohen nga furnizimi me gaz natyror të lëngshëm (LNG) nga tregjet ndërkombëtare, përfshirë SHBA-në. “Siguria energjetike nuk është vetëm çështje ekonomike. Ajo është çështje e sigurisë kombëtare, e stabilitetit të tregut dhe e mbrojtjes së qytetarëve dhe bizneseve nga krizat e ardhshme”, tha në përfundim të këtij studimi Agim Shahini, kryetar i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB).

HAGA DHE FORMIMI I INSTITUCIONEVE TË KOSOVËS



Lulëzim ETEMAJ

Edhe pse zgjedhjet e parakohshme u mbajtën më 7 qershor, Kosova ende nuk i ka formuar institucionet e reja shtetërore.

Pas Kuvendit, LDK kishte njoftuar në fund të korrikut se është hequr pezullimi i bisedimeve me VV-në për formimin e institucioneve të ardhshme të shtetit. Vetë ky zhvillim tregon se, pavarësisht deklaratave të mëhershme dhe vijave të kuqe, dinamika politike e këtyre dy partive vazhdon të diktohet më shumë nga rrethanat strategjike sesa nga retorika publike.

Edhe pse LDK ka qenë disa herë në koalicion me PDK-në, ato bashkëpunime kanë qenë kryesisht produkt i logjikës së PDK-së mbi ndërtimin e institucioneve, në njërin anë, dhe, në anën tjetër, i kulturës tradicionale institucionaliste të klasës së vjetër politike LDK-së, e jo domosdoshmërisht rezultat

i tejkalimit të dallimeve të thella politike e historike ndërmjet këtyre dy subjekteve. Në këtë kuptim, afrimi i mundshëm ndërmjet LDK-së dhe Vetëvendosjes mund të lexohet si zhvillim që mbështetet mbi interesa të përbashkëta politike në raport me PDK-në, pasardhësen politike të UÇK-së, të cilat derivojnë në fakt nga raporti i tyre me UÇK-në dhe nga një lexim final prej tyre të rrethanave në të cilat ndodhet vendi.

Në këtë funksion duhet parë edhe rolin e Presidentit të ardhshëm "konsensual" të VV-së dhe LDK-së.

Nëse një koalicion i tillë materializohet, ai do t'u japë më shumë peshë interpretimeve se kriza institucionale që ka shoqëruar Kosovën që nga fillimi i vitit të kaluar nuk është thjesht pasojë e mosmarrëveshjeve për ndarjen e pushtetit, por lidhet parasëgjithash me zhvillimet politike e juridike dhe të sigurisë që burojnë nga përfundimi i procesit gjyqësor ndaj katër krerëve të UÇK-së; Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi e Rexhep Selimi, në Dhomat e Specializuara në Hagë. Sipas këtij këndvështrimi, vonesat e deritanishme në

krijimin e institucioneve nuk ishin vetëm shprehje e polarizimit të zakonshëm politik, por pjesë e një pritjeje strategjike të VV-së dhe LDK-së për të parë ndikimin që mund të ketë vendimi përfundimtar i gjykatës në ekuilibrat e brendshëm politikë.

Nga kjo perspektivë, institucionet e ardhshme nuk do të përballen vetëm me sfidat e zakonshme të qeverisjes, si ekonominë, dialogun me Serbinë, integrimin evropian apo reformën në drejtësi, por edhe me menaxhimin e pasojave politike, shoqërore dhe psikologjike të vendimeve që do të dalin nga Haga. Çfarëdo qoftë epilogu i procesit, ai pritet të ketë ndikim në raportet ndërmjet partive politike, në perceptimin publik për luftën çlirimtare dhe në konfigurimin e skenës politike për vitet në vijim.

Në rast të një vendimi lirues për ish-krerët e UÇK-së, mund të argumentohet se qeverisja me mandat të plotë katërvjeçar do t'u krijonte partive në pushtet hapësirë dhe kushte për ta konsoliduar pozicionin e tyre dhe për të zbehur gradualisht ndikimin politik në radhë të parë të Thaçit dhe Veselit që mund të rikthehen në PDK dhe

në jetën publike. Një periudhë e gjatë pa zgjedhje do të mund të ndryshonte raportet elektorale dhe të zvogëlonte mundësinë që PDK-ja të rikthehej shpejt si forca kryesore politike.

Nga ana tjetër, në rast të një vendimi dënues, sfida kryesore e institucioneve do të ishte ruajtja e stabilitetit politik dhe e kohezionit shoqëror. LVV duket se e ka vlerësuar se menaxhimi edhe i një situatë të tillë të mundshme, kërkon një bazë më të gjerë politike. Një vendim i tillë do të kishte potencial të prodhonte reagime të forta emocionale në një pjesë të madhe të opinionit publik, veçanërisht te veteranët e luftës, familjet e dëshmorëve dhe ata që, edhe duke mos qenë në radhë të PDK-së dhe Aleancës, e konsiderojnë luftën e UÇK-së si themelin moral dhe politik të çlirimit dhe bërjes së shtetit të Kosovës.

Pikërisht këtu qëndron edhe dilema më e madhe politike. LDK-ja dhe Vetëvendosja kanë ndërtuar një pjesë të rëndësishme të identitetit të tyre politik duke goditur krerët e UÇK-së, jo vetëm ata që gjenden në Hagë, sado që herë pas here, ndonjë nga zyrtarët e tyre për qëllime elektorale, kanë shprehur respekt për luftën

çlirimtare dhe duke kërkuar mbrojtjen e vlerave të saj. Për pasojë, nëse këto dy subjekte do të ishin në qeveri në momentin e shpalljes së një vendimi dënues, do të përballëshin me përgjegjësinë e dyfishtë: nga njëra anë të garantonin rendin kushtetues dhe funksionimin normal të institucioneve, ndërsa nga ana tjetër të ruanin besueshmërinë e tyre para elektoratit dhe grupeve shoqërore që janë të lidhura me trashëgiminë e luftës.

Në fund, pavarësisht nëse interpretimi se zhvillimet politike diktohen nga procesi në Hagë rezultoi i saktë apo jo, mbetet e qartë se vendimet e Dhomave të Specializuara do të kenë ndikim përtej aspektit juridik. Ato do të ndikojnë në narrativën historike, në balancat politike, në raportet ndërmjet partive dhe në mënyrën se si shoqëri do ta ndërtojë kujtesën kolektive për luftën dhe shtetformimin. Për këtë arsye, qeveria që do të marrë përgjegjësinë në këtë periudhë do të gjykohej jo vetëm për mënyrën se si administron pushtetin, por edhe për mënyrën se si menaxhon një nga momentet më delikate politike dhe historike të Kosovës pas shpalljes së pavarësisë.



6 ÇËSHTJE QË DO TË PËRCAKTOJNË TRASHËGIMINË POLITIKE TË URSULA VON DER LEYEN

Ursula von der Leyen ka edhe tre vjet të mbetura për të çimentuar trashëgiminë e saj, por kjo nuk do të jetë aspak e lehtë. Mandati i dytë i Von der Leyen përfundon në vitin 2029, kohë në të cilën ajo do të ketë qenë në krye të Komisionit Evropian për një dekadë. Nëse, siç raportoi Brussels Playbook më parë këtë verë, shefja ekzekutive e BE-së nuk do të kërkojë një mandat të tretë, atëherë ajo është në fazën e fundit të karrierës së saj në Bruksel. Koha e saj në detyrë është dominuar nga menaxhimi i krizave – Covid-19, pushtimi në shkallë të plotë i Ukrainës nga Rusia, çmimet marramendëse të energjisë, lufta në Gaza. Në vitet që vijnë, sfidat ka të ngjarë të vazhdojnë të shtohen, duke përfshirë konkurrencën nga Kina dhe Shtetet e Bashkuara, dhe zgjedhjet e ardhshme në Francë, Spanjë, Itali dhe Poloni që mund të riformësojnë BE-në.

Në selinë e Komisionit në Berlaymont, von der Leyen dhe ekipi i saj po punojnë me eth për fjalimin e saj mbi Gjendjen e BE-së, i cili do të mbahet më 16 shtator. Atëherë ajo do të paraqesë planin e saj për vitet në vijim. Pas kësaj, ajo do të duhet të japë rezultate.

«Fjalimet janë të rëndësishme. Por janë veprimet ato që krijojnë trashëgimi», tha Martin Hojsík, nënkryetar i Parlamentit European nga grupi Renew Europe.

“Evropa është bërë më e cenueshme ekonomikisht, konkurrueshmëria mbetet një sfidë e madhe, pabarazitë sociale dhe rajonale vazhdojnë dhe shumë shpesh Komisioni i saj ka reaguar ndaj krizave në vend që t'i ketë parashikuar ato”, tha Victor Negrescu, një nënkryetar i Parlamentit nga grupi i Socialistëve dhe Demokratëve.

“Pres që ajo ta përdorë këtë moment për të mbrojtur rekordin e saj, por edhe për të shpjeguar se si Evropa mund të japë më shumë për rritjen, investimet, kohezionin social dhe autonominë strategjike. Për mua, pyetja e vërtetë nuk është se si paraqitet trashëgimia e saj, por çfarë rezultatesh konkrete do të shohin evropianët deri në fund të këtij mandati.”

Ja gjashtë probleme të mundshme që ka të ngjarë të përcaktojnë kohën e mbetur të von der Leyen në detyrë.

1. Përmbysja e rënies së Evropës

A do të jetë në gjendje von der Leyen të ndalë rënien ekonomike të kontinentit... apo të mbikëqyrë vdekjen e qendrave të tij industriale?

Ishte von der Leyen ajo që i kërkoj ish-kryeministrit italian dhe kreut të Bankës Qendrore Evropiane, Mario Draghi, të hartonte një raport mbi konkurrueshmërinë e kontinentit. Ai ishte brutal në vlerësimin e tij, duke thënë se “pa veprime, do të na duhet ose të bëjmë kompromis me mirëqenien tonë, mjedisin tonë ose lirinë

tonë”. Ai i bëri thirrje Evropës të investojë 800 miliardë euro shtesë në vit për të dalë nga një situatë e vështirë produktiviteti të ulët dhe rritjeje të dobët që po e shtyn atë pas SHBA-së dhe Kinës në rendin ndërkombëtar të kontrollit.

Von der Leyen premtoi ta shndërronte paralajmërimin e Draghi-t në një strategji industriale, por erërat e vështira janë të forta. Kompanitë evropiane përballen me çmime të larta të energjisë, tregje të fragmentuara të kapitalit, rregullim kompleks dhe konkurrencë në rritje nga jashtë.

Dhe ndërsa kompanitë evropiane kanë nevojë për tregjet dhe zinxhirët e furnizimit kinezë, kjo varësi vjen me një kosto të lartë. Subvencionet shtetërore u kanë lejuar firmave kineze të ndërtojnë kapacitete që tejkalojnë shumë kërkesën e brendshme, dhe automjetet e tyre elektrike, bateritë, panelet diellore dhe çeliku po ushtrojnë presion mbi rivalët e BE-së. Ndërkohë, kontrolli i Pekinit mbi mineralet kritike të përdorura në sektorët e tranzicionit të gjelbër dhe teknologjisë së lartë krijon një rrezik të madh.

“Ajo që keni parë me qëndrimin e BE-së në marrëdhëniet me Kinën është se status quo-ja është shumë e anuar në favor të Kinës dhe nuk mund të durojë”, tha një zyrtar i Komisionit, i cili nuk pranoi të fliste lirisht. “Në nivel të BE-së, tani ka një marrëveshje pothuajse të plotë për diagnostikimin e problemeve. Ka një marrëveshje pothuajse të plotë se cilat janë zgjidhjet për t’iu përgjigjur këtyre problemeve. Pyetja e vetme që mbetet është se sa të forta janë shtetet anëtare të jenë të gatshme të zbatojnë marrëveshjet e tyre.”

Dilema e Von der Leyen është se si ta mbajë tregun kinez të hapur, duke parandaluar që mbikapaciteti të shkatërrojë industrinë e BE-së.

Komisioni po mbikëqyr një rivendosje të marrëdhënieve me Kinën , ndërkohë që po shqyrton mjete dhe masa më të forta të mbrojtjes tregtare për të zvogëluar varësinë nga zinxhiri i furnizimit. Është një ekuilibër delikat: shumë përballje mund të shkaktojë një luftë tregtare të dëmshme; shumë pak mund ta lërë Evropën pa një bazë të qëndrueshme industriale.

Brukseli dhe Pekini janë të angazhuar në bisedime për të zgjidhur çështjen. Shefi i tregtisë Maroš Šefčovič ka vendosur një afat deri në tetor për të bërë përparim. Dështimi mund të nënkuptojë që Kina të bëhet fronti i radhës në luftën tregtare.

2. Mbrojtja e rregulloreve të BE-së nga Trump

A mundet von der Leyen të frenojë kompanitë e mëdha teknologjike pa u shndërruar në një përballje transatlantike çdo vendim evropian mbi konkurrencën, të dhënat, sovranitetin dixhital apo sigurinë e fëmijëve?

Akti i Tregjeve Dixhitale dhe Akti i Shërbimeve Dixhitale janë në

fazën e zbatimit të tyre, dhe gjokat e BE-së kundër Apple , Meta dhe Google tashmë e kanë zemëruar Uashingtonin . Von der Leyen po ecën përpara me planet për të kufizuar përdorimin e mediave sociale për fëmijët nën 13 vjeç, gjë që mund ta provokojë më tej Donald Trumpin.

“Ne nuk do të guxonim t’u tregonim SHBA-ve se si të rregullojnë territorin e tyre sovran. Dhe kjo është gjëja shumë e drejtë dhe koherente që kërkojmë në këmbim”, tha zyrtari i Komisionit i cituar më sipër.

3. Adresimi i krizës klimatike duke shkurtuar rregullat e gjelbra

Marrëveshja e Gjelbër ishte projekti përcaktues i mandatit të parë të von der Leyen. Por, me forcat e ekstremit të djathtë që po përhapen në të gjithë BE-në dhe një protestë se rregullat e gjelbra po i shtojnë presionin industrial Evropës, von der Leyen tani po detyrohet të anulojë pikërisht politikat që ajo zbatoi .

Fermerët kanë dalë në rrugët e Evropës ; industria dhe qeveritë po kërkojnë thjeshtëzim. Por Evropa po përballlet me valë ekstreme të nxehtësisë , zjarre dhe rreziqe klimatike që përkeqësohen, të cilat e bëjnë veprimin mjedisor më urgent se kurrë.

Nëse von der Leyen e dobëson shumë Paktin e Gjelbër, ajo rrezikon të humbasë besueshmërinë me qytetarët dhe partnerët e saj të koalicionit. Nëse ajo këmbëngul në rregulla ambicioze, ajo mund të provokojë më shumë reagime politike.

“Disa politika mjedisore u miratuan pa menduar për çështjet sociale”, pranoi Marie Toussaint, një eurodeputete franceze e të Gjelbërve. “Si ta ngrohni shtëpinë tuaj? Për disa njerëz, faturat janë tashmë të pamundura për t’u paguar. Pra, ne duhet të sigurohemi që në çdo sektor të kemi këtë shqetësim social dhe të përmbahemi nga miratimi i çdo gjëje që do të përkeqësonte jetën e njerëzve.”

4. Mbrojtja e Evropës dhe Ukrainës

Debati mbi sigurinë në Evropë është zhvendosur nga fjalimet rreth “autonomisë strategjike” në çështjen urgjente se ku mund të gjenden armët dhe të pengohet Presidenti rus Vladimir Putin.

BE-ja po rrit shpenzimet për mbrojtjen, po mbështet prokurimin e përbashkët dhe po përpiqet të zgjerojë kapacitetin industrial përmes iniciativave të tilla si programi SAFE prej 150 miliardë eurosh. Por qeveritë kombëtare ende nuk bien dakord se sa duhet të shpenzojnë dhe si ta shpenzojnë atë.

Testi është nëse Evropa mund të ndërtojë një industri mbrojtëse që mund të qëndrojë më vete, duke pasur parasysh minimin e përsëritur të NATO-s nga



administrata Trump.

Von der Leyen do të duhet gjithashtu të sigurojë që Ukraina të hyjë në çdo negociatë të mundshme paqeje me Rusinë në pozicionin më të mirë të mundshëm.

«Ne e dimë saktësisht se si të flasim me rusët», tha Ministri i Jashtëm Estonez Margus Tsahkna. «Presion, pa kompromise dhe vetëm nga [pozicioni] i forcës».

Kjo do të thotë që von der Leyen duhet të sigurojë që Ukraina të marrë mbështetje financiare dhe ushtarake, si dhe garanci të besueshme afatgjata të sigurisë, duke e mbajtur njëkohësisht administratën Trump në krah.

Por, ndërsa në Bruksel mbështetja për Ukrainën mbetet e lartë, qeveri më miqësore me Kremlinin kanë fituar pushtet në BE, me potencialin që të tjerët t’u bashkohen atyre pas një serie zgjedhjesh në vitin 2027, përfshirë në Francë dhe Itali.

“Ne operojmë në botën reale. Duhet të marrim parasysh realitetin politik dhe zhvillimet politike në punën që bëjmë”, tha zyrtari i Komisionit. Sidoqoftë, ata shtuan, “Presidentja von der Leyen do të vazhdojë të argumentojë për Ukrainën sepse kjo është qartësisht në interesin më të mirë të Evropës”.

Ukraina, Moldavia dhe vendet në Ballkanin Perëndimor janë afuar më shumë me BE-në, por mbështetja politike për zgjerimin nuk është e njëjtë me gatishmërinë për të pranuar anëtarë të rinj.

Vendet kandidatë duhet të përfundojnë ende reforma të vështira në sundimin e ligjit, korrupsionin dhe pavarësinë gjyqësore. Anëtarët aktualë të BE-së shqetësohen për koston e zgjerimit, nevojat e ardhshme për financim dhe nëse institucionet mund të funksionojnë me më shumë se 30 anëtarë.

Por von der Leyen duhet të tregojë se pranimi është ende një proces i besueshëm dhe jo një premtim i shtyrë përgjithmonë, përpara se vendet në dhomën e pritjes së BE-së të humbasin durimin dhe të kërkojnë diku tjetër aleanca.

«Ne meritojmë të jemi në një pozicion shumë më të avancuar sesa jemi tani», tha Ministri i Jashtëm i Maqedonisë së Veriut, Timço Mucunski, në lidhje me përpjekjen e vendit të tij për t’u bashkuar me BE-në, e cila ka ngecur. «Të thuash se jemi trajtuar padrejtësisht është një

nënvlerësim».

Buxheti i ardhshëm afatgjatë i BE-së do të përcaktojë se cilat nga këto dhimbje koke mund t'i trajtojë në të vërtetë von der Leyen.

Komisioni propozoi një buxhet prej gati 2 trilion eurosh për vitet 2028–2034, por dy kampe të rrënjosura po luftojnë për këtë plan.

Të ashtuquajturit Miq të Kohezionit — midis tyre Italia, Greqia, Polonia dhe Spanja — duan më shumë para për fushat tradicionale të shpenzimeve, veçanërisht politikën e kohezionit dhe Politikën e Përbashkët Bujqësore, dhe duan që këto fonde të ofrohen përmes kanaleve të njohura kombëtare dhe rajonale.

Kampi tjetër, i përbërë nga vende kursimtare, përfshirë Gjermaninë, Suedinë, Danimarkën dhe Holandën, dëshiron më pak shpenzime dhe një ndarje të ndryshme të parave të gatshme: më shumë për inovacionin, mbrojtjen dhe kapacitetin industrial evropian.

Lufta përplaset me kalendarin politik.

Një grup vendesh të mëdha të BE-së do të zhvillojnë zgjedhje në vitin 2027, përfshirë Francën, Italianë, Spanjën dhe Poloninë. Disa politikanë do të ngurrojnë t’u shpjegojnë votuesve pse duhet të dërgojnë më shumë para në Bruksel; të tjerë pse financimi tradicional duhet të reduktohet.

Megjithatë, buxheti i ri i BE-së (i njohur si Korniza Financiare Shumëvjeçare) duhet të hyjë në fuqi më 1 janar 2028. Kjo do të thotë që marrëveshja duhet të negociohet shumë kohë më parë. Sa më shumë që afrohet viti 2027, aq më shumë politika e brendshme do të dominojë bisedimet — dhe aq më e vështirë do të jetë të sigurohet unanimitet në Këshill dhe pëlqimi nga Parlamenti European.

“Kur bëhet fjalë për negociatat e MFF-së, negociatat përfundimtare janë gjithmonë të vështira, por gjithmonë arrihen”, tha zyrtari i Komisionit. “Pikërisht këto motivime [zgjedhjet e vitit 2027] janë faktorë fantastikë për ta kryer punën tani.”/Politico



EDMOND AZEMI RIKTHEHET TE SIGAL PRISHTINA

PRISHTINË, 31 GUSHT - Një prej rikthimeve më të bujshme në historinë e basketbollit të Kosovës tashmë është zyrtarizuar. Edmond Azemi do të jetë sërish pjesë e Sigal Prishtinës për sezonin 2026/27, duke u rikthyer në parket si basketbollist aktiv. Lajmin e ka konfirmuar klubi kryeqytetas përmes një postimi në rrjetet sociale. “Rikthehet ikona e klubit. Kapiteni legjendar, Edmond Azemi rikthehet si lojtar aktiv”, është thënë në njoftimin e Sigal Prishtinës. Rikthimi i Azemit është veçanërisht i veçantë, pasi ai ishte pensionuar nga basketbolli aktiv në vitin 2021, pas një karriere mbi dydekadëshe, gjatë së cilës u shndërrua në një prej figurave më të rëndësishme të klubit prishtinas dhe basketbollit të Kosovës. 45-vjeçari konsiderohet ndër basketbollistët më të dekoruar në historinë e basketbollit në Kosovë. Gjatë karrierës së tij ai ka fituar gjithsej 36 trofe, pjesën më të madhe me fanellën e Prishtinës. Përveç Sigal Prishtinës, Azemi ka luajtur edhe jashtë Kosovës, duke provuar aventurën në Shqipëri, Islandë dhe Mal të Zi. Me klubin nga kryeqyteti ai ka fituar edhe dy tituj të Ligës Ballkanike.

Prishtina bindëse ndaj Llapit, Drita fiton me vështirësi, Ballkani triumfon ndaj Drenicës

Prishtinë, 31 gusht - Xhiroja e tretë e Albi Mall Superligës së Kosovës ka sjellë rezultate interesante, me Prishtinën që ka regjistruar fitore bindëse ndaj Llapit, Dritën që ka triumfuar me vështirësi ndaj Vushtrrisë dhe Ballkanin që ka marrë tri pikë në udhëtim ndaj Drenicës.

Prishtina “shkatërron” Llapin 4:0

Prishtina ka shënuar një fitore të thellë 4:0 ndaj Llapit në sta-



diumin “Fadil Vokrri”, në derbin e xhiros së tretë. Kryeqytetasit e kanë nisur deshjen në mënyrën më të mirë të mundshme, duke kaluar në epërsi që në minutën e dytë. Assane Diatta ka realizuar për 1:0 dhe i dha skuadrës vendase avantazh të hershëm. Prishtina ka vazhduar të kontrollonte ritmin e ndeshjes, ndërsa në pjesën e dytë e ka thelluar edhe më shumë epërsinë. Albin Krasniqi ka shënuar në minutën e 63-të për 2:0, ndërsa Diatta ka realizuar golin e dytë personal në minutën e 71-të për 3:0. Rezultatit përfundimtar 4:0 e ka vulosur Arjanit Fazlija në minutën e 84-të. Kjo ishte fitorja e dytë e Prishtinës në po aq ndeshje të zhvilluara këtë sezon. Ndeshja e xhiros së dytë ndaj Dritës është shtyrë për shkak të angazhimit të gjilanasve në garat evropiane. Në anën tjetër, Llapi vazhdon me një start shumë të dobët në kampionat. Skuadra e Tahir Batatinës ka pësuar tri humbje në tri ndeshjet e para dhe aktualisht ndodhet në fund të tabelës pa pikë.

Drita mposht Vushtrrinë, Manaj vendos ndeshjen

Kampionia në fuqi, Drita, ka regjistruar fitoren e dytë në kampionat, pasi në Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali mposhti Vushtrrinë me rezultat 1:0. Ndeshja ishte e luftuar dhe me

shpejt dhe në minutën e 20-të Mërgim Pefqeli ka barazuar rezultatit në 1:1. Vendasit kanë rikthyer epërsinë në minutën e 38-të përmes Arbër Potokut, duke shkuar në pushim me avantazh 2:1. Në pjesën e dytë, skuadra nga Klina ka arritur ta barazojë përsëri rezultatit. Dient Isufi ka shënuar në minutën e 54-t për 2:2, rezultat që ka mbetur deri në fund të ndeshjes. Për Gjilanin ky ishte barazimi i parë i sezonit, pas dy fitoreve në dy xhirot e para. Dukagjini, ndërkohë, ka regjistruar barazimin e dytë dhe ka edhe një fitore. Ndeshja kishte edhe një rëndësi të veçantë për futbollin gjilanas, pasi është zhvilluar për herë të parë nën dritën e reflektorëve të rinj, të vendosur në kuadër të projektit të FFK-së “Ndriçojmë Futbollin”.

Malisheva fiton bindshëm ndaj Feronikelit '74

Malisheva është rikthyer te fitorja duke mposhtur në udhëtim Feronikelin '74 me rezultat 0:3. Kreshnik Uka ishte protagonist kryesor i takimit, duke realizuar dy gola. Uka e ka zhblokuar rezultatit në minutën e 10-të, ndërsa në minutën e 24-t Malisheva e e ka dyfishuar epërsinë përmes Laurent Xhylanit, i cili ishte i saktë nga pika e bardhë. Ai ka shënuar edhe golin e dytë personal në minutën e 56-të, duke vulosur fitoren 0:3. Pas tri xhirove, Malisheva ka grumbulluar shtatë pikë dhe është në krye të tabelës, ndërsa



Feronikeli '74 vazhdon pa pikë.

Ballkani nis me fitore epokën Sermaxhaj

Ballkani ka triumfuar 0:2 ndaj Drenicës në stadiumin “Bajram Aliu” në Skenderaj, në ndeshjen e parë të Sami Sermaxhaj në krye të skuadrës. Sermaxhaj është emëruar trajner i Ballkanit pas përfundimit të bashkëpunimit me kroatin Mislav Karoglan dhe debutimin e nisi me tri pikë. Drenica ka pasur mundësinë më të mirë në pjesën e parë për të kaluar në epërsi. Në minutën e 36-të vendasit kanë fituar penallti, por Genc Hamiti nuk ka arritur ta konkretizojë. Ballkani e ka gjetur golin e epërsisë në minutën e 70-të. Abou Dosso ka realizuar pas një aksioni individual, duke kaluar disa futbollistë të Drenicës dhe duke shënuar për 0:1. Dy minuta më vonë, Ballkani ka shënuar përsëri përmes Albin Berishës, por goli është anuluar nga VAR-i për pozitë jashtë loje. Fitoren e skuadrës nga Suhareka e ka vulosur Leart Popaj në minutën e 93-të, duke shënuar për rezultatit përfundimtar 0:2. Ballkani tani ka gjashtë pikë pas tri xhirove, ndërsa Drenica mbetet me dy pikë pas dy barazimeve dhe një humbjeje. Xhiroja e tretë ka krijuar garë interesante në pjesën e sipërme të tabelës, me Malishevën dhe Gjilanin që kryesojnë me nga shtatë pikë, ndërsa Prishtina, Drita dhe Ballkani ndjekin me nga gjashtë sosh.

RENDITJA TABELARE PAS XHIROS SË TRETË

Malisheva -	7 pikë
Gjilani -	7 pikë
Prishtina -	6 pikë
Drita -	6 pikë
Ballkani -	6 pikë
Dukagjini -	5 pikë
Drenica -	2 pikë
Feronikeli '74 -	0 pikë
Vushtrria -	0 pikë
Llapi -	0 pikë

Benzema mbetet lojtar i lirë

RIAD, 31 GUSHT - Karim Benzema është larguar zyrtarisht nga Al-Hilal pas vetëm gjashtë muajsh, duke mbetur lojtar i lirë. Klubi saudit ka arritur marrëveshje me sulmuesin francez për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të përbashkët.

Benzema, 38-vjeçar, ishte bashkuar Al-Hilalit në shkurt të këtij viti, pas largimit nga rivali Al-Ittihad. Me këtë të fundit, francezi kishte fituar titullin e kampionit dhe Kupën e Arabisë Saudite. Pas largimit të Benzemas, Al-Hilal tashmë ka siguruar

zëvendësimin e tij. Klubi ka transferuar sulmuesin anglez Ollie Watkins nga Aston Villa, i cili ka nënshkruar kontratë trevjeçare. Tashmë vëmendja është te e ardhmja e Benzemas. Sulmuesi francez duhet të vendosë nëse do të vazhdojë karrierën në

futbollin profesionist apo do t'i japë fund karrierës së tij. Raportimet e fundit flasin për mundësi të ndryshme, përfshirë vazhdimin e karrierës në Arabinë Saudite, ndërsa është raportuar edhe për interesim nga jashtë vendit.





Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT - Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, dhe nenin 18 dhe nenin 22 të Rregullores Nr. 13/25 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të miratuar nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L. "Përparimi" Sh. A e duke u bazuar në vendimin me nr. të protokollit 1930/26 të datës 31.08.2026 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L. "Përparimi" Sh. A, me datë 31.08.2026 shpall:

KONKURS PUBLIK I JASHTËM

- I. Titulli: Pastrues i Zyrave dhe Objekteve
Numri i ekzekutuesve: 10
Orët e punës: 40 orë në javë
Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.
Përgatitja profesionale: Shkolla fillore
Përvoja e punës: Nuk kërkohet përvojë pune
I raportoni: Udhëheqësit të Njesisë së Mirëmbajtjes - Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve
Koeficienti i pagës: 520.00 Euro Bruto

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Do të bëjë pastrimin e zyrave dhe objekteve varësisht nga marrëveshjet që ka punëdhënësi me palët e treta;
- Do të bëjë ruajtjen e mjeteve të punës të cilat përdoren për pastrim;
